



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E EKONOMISË SË MBETJEVE

SHPALLJE PËR POZICIONIN SPECIALIST

Në zbatim të Vendimin Nr. 132, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 12.06.2024 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve”:

Specialist i Shërbimeve Mbështetëse i Sektorit të Financës & Shërbimeve Mbështetëse, në Drejtorinë Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse

Afati për dorëzimin e dokumenteve 30/05/2025 pranë Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

1. Organizimi i punës në mbarëvajtjen e operacioneve të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.
2. Kontribuon në menaxhimin e magazinës dhe zbatimin e rregullave të marrjes në dorëzim të vlerave materiale dhe dokumentimi i daljes së tyre nga magazina.
3. Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe komode të punës për punonjësit e Agjencisë.
4. Gjykon dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e aseteve të institucionit.
5. Bashkërendimi i nevojave të stafit për realizimin e shërbimeve të punës që ato kryejnë, lidhur me sigurimin e transportit me mjetet e punës etj.
6. Mbikëqyr mbajtjen pastër të ambienteve të institucionit.

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim si dhe kriteret e veçanta si vijon:

- a. Të jetë shtetas shqiptar;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojnë diplomë të ciklit të parë të studimeve, të nivelit “Bachelor”, në shkenca Juridike, Ekonomike, Shoqërore, Komunikimi;
- d. Të kenë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune;

- e. Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale;
- f. Të mos ketë konflikt interesi në ushtrimin e detyrës;
- g. Të ketë njohuri shumë të mira profesionale të çështjeve teknike dhe aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe organizuar punën;
- h. Të ketë aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritetet dhe respektuar afatet;
- i. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;
- j. Të ketë aftësi analitike dhe fleksibilitet në pranimin e metodave dhe procedurave të reja
- k. Të kenë aftësi të mira të procedurave administrative.

KUSHTET PËR PRANIM DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës/diplomave dhe listes së notave (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore (në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punës);
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Certifikata për trajnime në lidhje me pozicionin për të cilin konkurojnë;
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen drejtpërsëdrejti në Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve brenda datës **30.05.2025**.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT TË DOKUMENTACIONIT

Komisioni Ad-Hoc do të shpallë në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve www.akem.gov.al, tek kategoria/menjuja “Njoftimet”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për intervistën e strukturuar me gojë, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të intervistohen për njohuritë mbi dokumentet e listuara më poshtë:

- Njohuri mbi Ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;

- Njohuri për Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimi e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Njohuritë mbi Ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen edhe në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE KOMUNIKIMI

Kandidatët do të vlerësohen me pikë si më poshtë:

- a- Intervistën e strukturuar me gojë, deri në 60 pikë;
- b- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 40 pikë.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesit në faqen zyrtare të AKEM.

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumentacioneve të cituara më sipër, duhet të bëhet brenda datës **30.05.2025** në protokollin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.

Zhvillimi i intervistës do të zhvillohet në datën **04.06.2025**, në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve.